

Zyrës së doktoratave të Universitetit të Tetovës
Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit juridik të Universitetit të Tetovës

Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit juridik i Universitetit të Tetovës, në mbledhjen e mbajtur më 29.09.2020, solli Vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin shkencor dhe profesional të dorëshkrimit të temës së doktoratës, me titull **“Roli i organizatave ndërkombëtare në menaxhimin e krizës dhe ndërtimin e paqes në Kosovë (1998-1999)”**, të kandidatit Mr. sc. Valmir Hylenaj.

Në bazë të vendimit nr. 13-769/2, të datës 29.09.2020, Komisioni në përbërje: Prof. Dr. Drita Mahmuti-Fazlija (kryetare), Prof. Dr. Qebir Avziu, Prof. Dr. Bashkim Selmani, Prof. Dr. Jusuf Zejneli, (anëtarë) dhe Prof. Dr. Fehari Ramadani (mentor), pasi lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit juridik i paraqet këtë

R A P O R T
për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës

Të dhënat biografike të kandidatit:

Mr. sc. Valmir Hylenaj është i lindur, më 30 korrik 1980, në fshatin Klina e Epërme të Komunës së Skenderajt. Shkollën fillore e mbaroi në fshatin e tij të lindjes, ndërsa atë të mesme në Mitrovicë. Studimet bachelor i ka mbaruar në Universitetin e Prishtinës, ndërsa ato master ne Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë.

Në vitin 2000-2009 ka punuar si Oficer-gradë e Togerit në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës. Gjatë viteve 2009-2011, ka punuar si Udhëheqës në zyrën për marrëdhënie me Publikun në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”.

Gjatë viteve 2012-2019 ka punuar si Sekretar i përgjithshëm i Kompanisë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”.

Nga viti 2016-2017, me kohë të pjesshme ka ligjëruar në Fakultetin Juridik në Kolegjin Evropian "Juridica" në Prishtinë.

Nga viti 2019, e në vazhdim ushtron funksionin e zëvendës-drejtorit në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror në Prishtinë.

Deri më tani, Mr. sc. Valmir Hylenaj ka botuar këto punim shkencore:

1. **Ushtria Çlirimtare e Kosovës, Bazë e Shtetbërjes dhe garancion i Pavarësisë së Kosovës.** KOSOVA ASSOCIATION FOR POLITICAL SCIENCE STUDENTS ASSHP Revista Politikum Nr. 1. Janar, 2008;
2. **Identiteti Kosovar Ekziston apo nuk Ekziston?** KOSOVA ASSOCIATION FOR POLITICAL SCIENCE STUDENTS ASSHP. Revista Politikum, nr. 3. Qershor 2008;
3. **Bashkëpunimi Ndërkombëtar për Paqe.** Revista Diskutimi, nr. 12. Korrik 2014, ISSN:1857-825X; Online:ISSN 1857-8543;
4. **Euroatlantizmi në rendin e ri botëror.** Globalchallenge, nr. 7 nëntor 2013; ISSN227-8540 ISSN2312-5748 (online);
5. **Aktoret me ndikim më të madh Rajonal-SHBA dhe ndihma e BE-së në Ballkan.** Globalchallenge, VOL. IV, nr. 2. Maj-2015; ISSN227-8540; ISSN2312-5748 (online);
6. **Funksionimi dhe zhvillimi i Shoqërisë Civile ne Kosovë.** Globalchallenge VOL. V, Numri 3; Gusht, 2016; ISSN 2227-8540; ISSN 2312-5748 (online);
7. **International Humanitarian intervention in Kosovo.** Academic Journal of Business, Administration, Law and Social Sciences, vol. 2, No.1. March, 2016. ISSN 2410-3918 (print) ISSN 2410-8693 (online);
8. **WHY DID THE SOUTH LOSE THE AMERICAN CIVIL WAR. CONTEMPORARY MACEDONIAN DEFENCE,** (Ebsco-Host) INTERNATIONAL SCIENTIFIC JOURNAL. Vol. 18, No. 35. December, 2018; ISSN 1409-8199; e-ISSN 1857-887X.

Pasqyrë e aktiviteteve të realizuara nga kandidati gjatë studimeve të doktoratës:

Kandidati Valmir Hylenaj që nga fillimi i studimeve në ciklin e tretë e deri më sot ka dëshmuar interes dhe progres të kënaqshëm në fushën e hulumtimit dhe të punimit të temës. Ai me sukses ka realizuar tre konferencat doktrate, gjatë të cilave ka prezantuar rezultatet e hulumtimit. Gjatë kësaj periudhe ka botuar disa artikuj shkencor.

Analizë punimit: “Roli i organizatave ndërkombëtare në menaxhimin e krizës dhe ndërtimin e paqes në Kosovë (1998-1999)”

Në disertacionin e tij të doktoraturës me titull “**Roli i organizatave ndërkombëtare në menaxhimin e krizës dhe ndërtimin e paqes në Kosovë (1998-1999)**”, trajton rolin e organizatave ndërkombëtare në menaxhimin e krizës dhe ndërtimin e paqes në Kosovë gjatë viteve 1998-1999, sikurse edhe rrjedhat e këtij zhvillimi politik-ushtarak, konferencat ndërkombëtare (për këtë çështje); intervenimin humanitar (ndërhyrja ushtarake e forcave Veri-Atlantike, NATO-s), në Kosovë.

Në punimin e tij, kandidati është përpjekur të trajtoj arsyet dhe ligjshmërinë e ndërhyrjes humanitare të forcave të NATO-s në Kosovë, gjatë vitit 1999; ndërhyrje e cila e shpëtoi popullin shqiptar të Kosovës, nga torturat çnjerëzore, aktet gjenocidiale dhe shfarosja e plotë, si pasojë e politikës shtetërore serbe.

Mr. sc. Valmir Hylenaj është përpjekur të bëjë analizë sintetike dhe të thelluar të çështjes së ndërhyrjes ndërkombëtare në Kosovë, duke trajtuar bashkëpunimin midis shteteve dhe organizatave të ndryshme, por njëkohësisht edhe kontradiktat që ekzistonin midis tyre. Në punimin e tij, kandidati ka arritur të argumentoj se pavarësisht dallimeve, u arrit të realizohet ndërhyrja e jashtme, e cila i dha fund spastrimit etnik, të cilin shteti serb përpiqej ta realizonte gjatë asaj periudhe në Kosovë. Me punimin e tij, ai ka arritur të argumentoj se ndërhyrja ushtarake kishte qëllime humanitare, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, e cila rezultoi me marrëveshjen e Kumanovës, së 12 qershorit 1999, me të cilën forcat serbe u detyruan të tërhiqeshin përfundimisht nga Kosova.

Vend me rëndësi në punim zënë edhe përpjekjet e faktorit ndërkombëtar për t’i dhënë fund gjenocidit shtetëror serb mbi popullsinë shqiptare, nëpërmjet arritjes së një marrëveshje midis dy palëve në konflikt (shtetit serb dhe shqiptarëve). Por, përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare, nuk arritën ta bindnin qeverinë serbe të nënshkruante Marrëveshjen e Rambujesë. Kandidati i ka kushtuar rëndësi edhe raporteve të UÇK-së dhe organizatave të huaja, duke argumentuar se lufta e shqiptarëve kishte karakter mbrojtës dhe njëkohësisht se luftëtarët shqiptarë respektonin në vazhdimësi ligjet e luftës.

Kandidati ka trajtuar gjithashtu pasojat nga lufta për Kosovën dhe shqiptarët; dëmet e mëdha materiale dhe humanitare të shkaktuara nga shteti serb; përpjekjet e hapura të qeverisë së

Beogradit për spastrim etnik në Kosovë; zhvendosjen e mbi 1 milion civilëve nga territori i Kosovës.

Kthimi i popullatës shqiptare (të shpërngulur dhunshëm) në vendbanimet e tyre dhe vendosja e jetës normale në Kosovë, pas 12 qershorit 1999, përbëjnë argumente shtesë se ndërhyrja ushtarake e NATO-s në Kosovë pati rëndësi të madhe humanitare, pasi shpëtoi nga shfarosja e plotë një popullsi të tërë.

Tema është ndërtuar nga Parathënia, Hyrja, pesë kapituj, Përfundimi dhe Bibliografia.

Kapitulli i parë, i cili përfaqëson boshtin e këtij studimi monografik, përfshin gjendjen dhe parakushtet për intervenimin ndërkombëtar në Kosovë. Aty është trajtuar gjendja në Kosovë gjatë viteve 90, në periudhën që pasoi suprimimin e Kushtetutës së Kosovës. Kandidati ka pasqyruar përkeqësimin e situatës në atë kohë; qëndrimin e partive politike në Kosovë dhe mungesën e veprimit të tyre; poshtërimin, dhunën, torturat, burgosjet e përditshme që shteti serb ushtronte mbi popullsinë shqiptare. Në këtë kapitull vend me rëndësi zë trajtimi i shkaqeve të formimit të formacioneve të armatosura në Kosovë, duke filluar me themelimin dhe daljen në skenë e UÇK-së, dhe duke vazhduar me ngritjen e saj në një ushtri vullnetare, e cila u shndërrua në faktor shumë të rëndësishëm në vitet 1998-1999. Një vend i rëndësishëm i është kushtuar rolit dhe rëndësisë së protestave të studentëve të 1 Tetorit 1997, reagimet dhe përkrahja e tyre nga qendrat e ndryshme ballkanike dhe evropiane, si dhe nga SHBA-ja. Në këtë kapitull, është shqyrtuar zhvillimi i konferencës së Rambujesë, platforma politike e delegacionit të Kosovës në këtë konferencë, bisedimet, kontradiktat e deri te marrëveshja dhe koha e nënshkrimit. Gjithashtu, do të trajtohet marrëveshja e Kumanovës, si dhe vendosja e trupave të NATO-s në Kosovë etj.

Kapitulli i dytë merr në shqyrtim çështjen e pozicionimit të NATO-s dhe trajton problemet e ligjshmërisë dhe të së drejtës sipas konventave ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut, për të intervenuar për çështje humanitare, në luftën e Kosovës (1998-1999). Në këtë kapitull janë dhënë argumente për të drejtën e intervenimit të NATO-s në Kosovë, edhe pa mandatin e Këshillit të Sigurimit. Secili nënkapitull është shqyrtuar dhe janë dhënë sqarime, si: *Pikëpamjet dhe dilemat rreth të së drejtës për intervenimin ndërkombëtar; Përkufizimi i ndërhyrjes së NATO-s; E drejta humanitare ndërkombëtare; Spastrimi etnik, shpërngulja dhe masakrat në Kosovë.* Në këtë kapitull, duke u mbështetur në faktografinë bindëse, është

argumentuar se NATO-ja kishte luajtur rolin kryesor në mbrojtjen e vlerave demokratike, në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në dhënien fund të gjenocidit dhe të spastrimit etnik.

Kapitulli i tretë trajton rolin e organizatave ndërkombëtare, si: OKB, NATO, BE, OSBE në menaxhimin e krizës në Kosovë (1998-1999). Kapitulli në fjalë shtjellohet si një tërësi e veçantë dhe ndërlidhet në mënyrë lineare me kapitullin e katërt.

Ndërkaq, **kapitulli i katërt** bën fjalë për përparësitë, mangësitë dhe instrumentet që janë vendosur nga komuniteti ndërkombëtar në menaxhimin e krizave ose vendosjen e paqes, duke i elaboruar sukseset dhe mosukseset mes organizatave ndërkombëtare, (gjithmonë duke bërë krahasime me rrjedhat e ngjarjeve në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në vendet e tjera në ish-Jugosllavi). Janë shqyrtuar sukseset e OKB-së në fushën e sigurisë dhe të zhvillimit ekonomik, sikurse edhe arritjet e OKB-së në fushën e demokracisë, gjatë qeverisjes së tyre në Kosovë, pastaj dhe sukseset e Kombeve të Bashkuara në krizat rajonale dhe konfliktet e ndryshme të menaxhuara nga to.

Kapitulli i pestë bën fjalë për vendosjen dhe rolin e administrimit ndërkombëtar në Kosovë, misionin e përkohshëm civil të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, UNMIK-un, sipas rezolutës 1244 nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara. Më pas, do të trajtohet edhe procesi i shpalljes së pavarësisë së Kosovës, njohjet e para ndërkombëtare; Kosova dhe proceset deri te pranimi në OKB, si dhe GJND-ja dhe rasti i Kosovës etj.

Kandidati është përpjekur të shtjelloj rëndësinë historike të intervenimit të NATO-s në Kosovë, duke e argumentuar atë si çështje humanitare. Situatat, momentet, fenomenet dhe çështjet historike janë shënuar, regjistruar e përshkruar me shumë saktësi e besnikëri, duke pasqyruar tërë angazhimin dhe organizimin politik në Kosovë gjatë viteve 1998-1999, dhe në tërë këtë punë gjithëpërmbledhëse, së pari herë të shtruar dhe trajtuar në këtë mënyrë, analizuar e studiuar në këtë formë studimore në historiografinë shqiptare, është dëshmuar angazhim serioz dhe konciz.

Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura:

Gjatë hartimit të këtij punimi doktorate, me titull “**Roli i organizatave ndërkombëtare në menaxhimin e krizës dhe ndërtimin e paqes në Kosovë (1998-1999)**” kandidati i është përmbajtur respektimit të standardeve metodologjike në punën kërkimore-shkencore. Janë

shfrytëzuar disa metoda shkencore, si ajo: e analizës, historike, krahasuese, empirike, e intervistimit etj. pasi tema është e kufizuar në periudhë kohore (1998-1999) dhe një hapësirë të caktuar gjeografike, ndarja e saj është bërë mbi bazë tematike.

Për përgatitjen e temës, kandidati ka shfrytëzuar literaturë të pasur, gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, artikuj shkencor, gazeta të kohës, materiale nga interneti etj.

Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit:

Tema e doktoratës “**Roli i organizatave ndërkombëtare në menaxhimin e krizës dhe ndërtimin e paqes në Kosovë (1998-1999)**”, përbën një përpjekje nga ana e kandidatit për të argumentuar ligjshmërinë e ndërhyrjes ndërkombëtare për të shpëtuar një popull të tërë nga zhdukja, rolin e organizatave ndërkombëtare në menaxhimin e luftës në Kosovë dhe kontributin e tyre në ndërtimin e paqes.

Me punën e tij, kandidati ka arritur të pasqyroj politikën shfarosëse që shteti serb zhvilloi në Kosovë, që nga pushtimi i Kosovës më 1912, e në mënyrë të veçantë pas suprimimit të autonomisë së Kosovës në vitin 1989 dhe deri në përfundimin e periudhës së pushtimit, në qershor 1999. Ka argumentuar se ndërhyrja e jashtme kishte qëllime humanitare dhe pavarësisht se NATO nuk mori leje nga OKB-ja për intervenim, veprimi i saj ishte i ligjshëm, pasi i dha fund politikës koloniale, që Serbia kishte zhvilluar në Kosovë, gati një shekull.

Kandidati ka arritur të argumentoj se qëllimi i politikës serbe në Kosovë, në vitet 90 ishte ndryshimi i strukturës etnike të popullsisë. Një pjesë e popullsisë shqiptare do të vriteshin, pjesa më e madhe do të detyroheshin dhunshëm të largoheshin nga vendbanimet e tyre dhe një pjesë e vogël që do të mbetej, do të asimilohej lehtësisht.

Kontributet kryesore shkencore të kandidatit:

Tema të cilën e ka punuar kandidati i takon periudhës së afërt prandaj, nuk është trajtuar gjerësisht nga studiuesit deri tani. Ky studim do të shërbej si nxitje në të ardhmen që kjo temë të hulumtohet më gjerësisht nga studiues të tjerë.

Kandidati ka shfrytëzuar burime relevante, të cilat e bëjnë temën të rezistueshme nga kritikata shkencore. Ai ka bërë krahasim të burimeve të ndryshme, të cilave u është qasur në mënyrë shkencore.

E veçanta e kësaj teme qëndron në faktin se kandidati ka arritur të realizoj intervista me disa nga protagonistët kryesorë të ngjarjeve dhe zhvillimeve, të cilat trajtohen në temë.

Hulumtime të mundshme në të ardhmen:


Tema e doktoratës “Roli i organizatave ndërkombëtare në menaxhimin e krizës dhe ndërtimin e paqes në Kosovë (1998-1999)” është e gjerë dhe brenda saj janë trajtuar çështje të ndryshme, çka jep mundësi që në të ardhmen kandidati ose studiues të tjerë të trajtojnë çështje të veçanta.

Kandidati ka bërë përpjekje për të dhënë pasqyrë sa më të plotë të ngjarjeve, të cilat lidhen me temën. Puna e tij përbën kontribut të çmueshëm jo vetëm për fushën juridike, por edhe për historinë shqiptare të periudhës më të re. Prandaj, tema e tij mund të shërbej si pikënisje për thellimin e hulumtimeve për njëriçën ndër ngjarjet më të rëndësishme të historisë sonë kombëtare.

Vlerësim dhe rekomandim:

Nisur nga vlerësimet e mësipërme Komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së doktoratës “Roli i organizatave ndërkombëtare në menaxhimin e krizës dhe ndërtimin e paqes në Kosovë (1998-1999)”, të kandidatit Mr. sc. Valmir Hylenaj, ka nderin që t’i propozoj Këshillimit mësimor-shkencor të Fakultetit juridik miratimin e këtij raporti dhe krijimin e kushteve për mbrojtjen publike të kësaj teme të doktoratës.

Komisioni:

1. Prof. Dr. Drita Mahmuti-Fazlija,  ;
2. Prof. Dr. Qebir Avziu,  ;
3. Prof. Dr. Bashkim Selmani,  ;
4. Prof. Dr. Jusuf Zejneli,  ;
5. Prof. Dr. Fehari Ramadani,  .

Tetovë, shtator 2020